

Vendim nr. 291, datë 10.11.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 10.11.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (P) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **PAL GJONPJETRI**, përfaqësuar nga avokat Sokol Berberi, me prokurë të përgjithshme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 2914, datë 27.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr. 1465, datë 22.12.2014 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2024-4136 datë 23.10.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Konstatimi i shkeljeve kushtetuese dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në trajtimin e çështjes së ankuesit.

Pavlefshmëria e pjesshme e veprimit juridik të kontratës së shitblerjes nr. 227 dhe nr. kol. 128, datë 30.01.2007, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme. Pavlefshmëria e pjesshme e veprimit juridik nr. 189, datë 01.11.1996.

Dërgimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin**

**dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të
Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr.
8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Bashkia Shkodër në datën 22.11.1993 ka lidhur aktmarrëveshje mes saj dhe kërkuessit Pal Gjonpjetri mbi zënien e një ambienti, duke u lejuar të kryejë punimet e domosdoshme për ta kthyer në ambient banimi. Afati i qëndrimit të tij është i lidhur me kohën e vënies në punë të atyre ambienteve. Me vendimin nr. 2423, datë 13.09.1994, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: “Vërtetimin e faktit juridik të pronësisë së Pal Gjonpjetri mbi një shtëpi banimi të ndodhur në lagjen “Ndoc Mazi”. Ndërsa me vendimin nr. 18, datë 23.5.1995, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka interpretuar vendimin nr. 2433, datë 13.9.1994, duke shtuar pas fjalës “banjë”, në paragrafin e fundit të pjesës urdhëruese, fjalët “dhe e rrethuar me mur avulli në tre drejtime, me sipërfaqe të përgjithshme 920 m²”. Këto vendime kërkuessit i ka regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (*ZRPP-ja, Shkodër*).

2. Në zbatim të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar është përcaktuar që ish-ndërmarrja Artistike Përpunim Bakri, me sipërfaqe 2321 m², ku pjesë është edhe objekti i konfliktit gjyqësor, do të shitej. Bazuar në kontratën e shitjes nr. 189, datë 01.11.1996, të lidhur mes palës shitëse, Dega e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Shkodër (*AKP-ja Shkodër*), ka realizuar shitjen e truallit, sipërfaqe funksionale e domosdoshme e objektit, palës blerëse, të paditurës S.D., sipas vërtetimit të hipotekës nr. 2214, datë 31.10.1996. Si objekt i kësaj kontrate është sipërfaqja e truallit e domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të objektit punime bakri me sipërfaqe 2321 m².

3. Më 30.01.2007 e paditura S.D., me cilësinë e shitëses, i ka shitur blerëses D.P., me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme truall dhe ndërtesë, pronë të cilën më pas pronarja e re e ka regjistruar sipas vërtetimit të pronësisë më 05.02.2007 të lëshuar nga ZVRPP Shkodër. Në vitin 2008, midis palës së paditur D.P. dhe kërkuessit ka lindur një konflikt civil, lidhur me posedimin dhe të drejtat e pronësisë mbi sendin, objekt gjykimi. Me vendimin civil nr. 3294,

datë 09.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, midis së tjerave është vendosur detyrimi i kërkuarit (palës paditëse në këtë proces civil) t'i kthejë shtetases D.P. një sipërfaqe trualli prej 897 m² dhe një sipërfaqe ndërtimore prej 56 m².

4. Në vijim, kërkuari, në datën 13.1.2012, duke pretenduar të drejta pronësie mbi sendin objekt gjykimi, për të fituar posedimin e tij, i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt pavlefshmërinë e pjesshme të veprimit juridik të kontratës së shitblerjes nr.227 rep., dhe nr. 128 kol, datë 30.1.2007, duke u kthyer në gjendjen e mëparshme si dhe pavlefshmërinë e pjesshme të veprimit juridik (kontratë shitblerjeje trualli) nr. 189, datë 1.11.1996, me mandat arkëtimi nr. 051839, datë 18.11.1996, me shitës Degën e AKP-së, Shkodër dhe blerëse S.D., duke paditur S.D., D.P. dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Pronës Publike në Ministrinë e Financave.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 2914, datë 27.11.2012, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkuari nuk e ka fituar asnjëherë të drejtën e pretenduar mbi objektin “ndërmarrje e Përpunim Bakrit”, që ai e ka pasur në përdorim me afat deri kur kjo ndërmarrje të fillojë aktivitetin. Ajo gjykatë ka vlerësuar se kërkuari, nuk i ka argumentuar gjykatës se cili interes i ligjshëm i është cenuar (real apo detyrimor), që kërkon ta rivendosë dhe cilën të drejtë të mohuar kërkon që i padituri të detyrohet t’ia njohë. Në përfundim, ajo gjykatë ka konkluduar se kontratat juridike janë të ligjshme. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuari.

6. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 1465, datë 22.12.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.2914, datë 27.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në marrjen e vendimit Gjykata e Apelit Shkodër ka arsyetuar se kërkuari, në vështrim të nenit 163 të Kodit Civil, nuk ka fituar të drejta të pronësisë mbi sendin objekt gjykimi, pasi aktmarrëveshja, datë 22.11.1993, e lidhur midis kërkuarit, Bashkisë Shkodër dhe nëpunësit të strehimit, nuk ishte mjet juridik (mënyrë e fitimit të pronësisë) për të fituar të drejta pronësie mbi sendin. Mbi bazën e këtij akti, arsyeton gjykata e apelit, pala paditëse ka fituar posedimin e kufizuar, mbi disa ambiente të ish-ndërmarrjes së Përpunim Bakrit, Shkodër, ndërsa organet e mësipërme nuk kanë pasur asnjë të drejtë pronësie dhe disponimi mbi këtë send. Ashtu sikundër është provuar gjatë procesit në gjykatën e shkallës së parë, pronësia e sendit ka kaluar në mënyrë të ligjshme në favor të palës së paditur.

7. Mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuari, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4136, datë 23.10.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari me arsyetimin se nuk rezultonin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile. Kolegji Civil ka arsyetuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe

zbatuar drejtë atë dhe se vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

8. Në datën 06.05.2025 (sipas shërbimit postar), kërkuesi, ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 22.08.2025. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkueti**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar:

- 9.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, si pasojë e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të disponibilitetit, parimit të kontradiktoritetit dhe parimit të barazisë së armëve dhe së drejtës për t’u njohur me dosjet.
- 9.2. *E drejta e pronës private dhe parimi i barazisë përpara ligjit*, si pasojë e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt ligjor të kryer nga gjykatat e zakonshme.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuesin. Në këtë drejtim, mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit kriter që të vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimin nr. 112, datë 30.04.2025 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

12. Në rastin konkret, duke mbajtur në konsideratë natyrën kumulative të kriterëve paraprake dhe rrethanat e çështjes, Kolegji çmon të ndalet në analizën e legjitimitetit *ratione materiae*. Kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, parimit të gjykatës së caktuar me ligj, parimit të disponibilitetit, parimit të kontradiktoritetit dhe parimit të barazisë së armëve, si dhe së drejtës për t'u njohur me dosjet. Po kështu, ai ka pretenduar edhe faktin se si pasojë e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt ligjor të kryer nga gjykatat e zakonshme atij i është cenuar edhe e drejta e pronës dhe parimi i barazisë përpara ligjit.

13. Duke marrë në analizë këto pretendime, Kolegji vëren se kërkuesi në ankimin kushtetues individual, pavarësisht se ka ngritur disa pretendime me natyrë kushtetuese, në thelb, ai është mjaftuar vetëm duke i përmendur ato, pa dhënë asnjë argument ligjor se në çfarë mënyre dhe cila gjykatë i ka kryer këto shkelje. Në këtë kontekst, duke mbajtur parasysh jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrorë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre (*shih vendimet nr. 57, datë 25.07.2017; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 45, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*), Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente në nivel kushtetues, për rrjedhojë kërkimet e tij janë haptazi të pabazuara.

14. Për sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.